



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 26, datë 19.02.2025

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "THE CONCAVE, OBJEKT
HOTELERI 3 DHE 4 KAT ME 2-5 KATE NËNTOKË DHE PISHINA", ME
VENDNDODHJE NË LLAMAN, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Bega-07" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "The Concave, Objekt hoteleri 3 dhe 4 kat me 2-5 kate nëntokë dhe pishina", me vendndodhje në Llaman, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Bega-07" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 11/02/ 2026